



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 05, datë 07.03.2016

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1, DATË 30.07.2015 “PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE QË DO TË NDIQEN NGA
AUTORITETET E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE
PËR LEJE NDËRTIMI DERI NË MIRATIMIN E PLANEVE TË PËRGJITHSHME
VENDORE”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit

VENDOSI:

1. Në Vendimin Nr. 1, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga Autoritetet e Zhvillimit të Territorit për shqyrtimin e kërkesave për Leje Ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

a) Në pikën 3 shtohet paragrafi me përmbajtje si më poshtë:

2. *Autoritetet e zhvillimit të territorit lejohen të japin leje ndërtimi për rastet përjashtimore të pikës 2, vetëm brenda zonave të urbanizuara, të identifikuara sipas vendimit Nr. 5, datë 29.12.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit, me përjashtim të strukturave sipas gjermës e), për të cilat zbatohet VKM Nr. 283, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtoriale, në tokë bujqësore”, e ndryshuar me përjashtim të strukturave sipas gjermave d), dhe me përjashtim të banesave individuale/njëfamiljare sipas pikës ë), me kushtin që toka ku do të ndërtohet të jetë me statusin aktual “truall”.*

b) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me përmbajtje si më poshtë:

3/1 Konvertimi nga resursi i tokës “arë” në “truall” për strukturat sipas gjermës d) do të kryhet sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

c) Pika 5 zëvendësohet me fjalinë si më poshtë:

Autoritetet e zhvillimit të territorit duhet të vijojnë me miratimin e kërkesave për leje ndërtimi për rastet sipas pikës 2 të këtij vendimi, vetëm pas marrjes së njoftimit nga AZHT për konformitetin e zhvillimit të propozuar me rastet përjashtimore të përmendura më sipër, në rrugë elektronike nëpërmjet Regjistrit të Integruar të Territorit, si dhe informimit të Këshillit Kombëtar të Territorit lidhur me këtë konformitet.

d) Pika 9 zëvendësohet me fjalinë si më poshtë:

Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, si dhe të gjitha autoritetet e zhvillimit ndërsa inspektimi, në nivel vendor dhe kombëtar, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

e) Pas pikës 11 shtohet pika 11/1 me përmbajtje si më poshtë:

Dipozitat e Vendimit Nr. 5, datë 29.12.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban", të cilat bien ndesh me këtë Vendim shfuqizohen.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

